



GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhoma e shkallës së dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, Saranda Bogaj – Sheremeti dhe Franciska Zhitija - Ymeri, anëtare të kolegjit, në çështjen juridike - konfliktin administrativ sipas paditesit-propozuesit Pajtimi -14 shpk me seli ne Malishevë, kundër kundërshtares se propozimit - të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës me seli ne Prishtine, me bazë juridike për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, nr. 08/2024 te datës 26.01.2024, duke vendosur lidhur me ankesën e kundër propozuesit - te paditurit kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së parë, Departamenti Fiskal KF.nr.124/24, të datës 01.03.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 05.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e kundërpropozuesit - te paditurës Administrata Tatimore e Kosovës me seli ne Prishtine, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale Dhomat e Shkallës së parë, Departamenti Fiskal KF.nr.124/24, të datës 01.03.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e Gjykatës Komerciale Dhomat e Shkallës së parë, Departamenti Fiskal, është vendosur si ne vijim:

- I. **APROVOHET SI I BAZUAR** propozimi - kërkesa e paditesit-propozuesit Oti Petrol Sh.P.K., me seli ne Prishtine, per shtyrjen e ekzekutimit te aktit administrativ - vendimit nr. 08/2024 të datës 26.01.2024, te Administratës Tatimore te Kosovës me seli ne Prishtine.
- II. **SHTYHET** ekzekutimi i vendimit nr.08/2024 të dates 26.01.2024, i Administrates Tatimore te Kosovës me seli ne Prishtine, deri ne vendosjen e këtij kontesti tregtar - administrativ me vendim perfundimtar giyqësor.

Kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale Dhomat e Shkallës së parë, Administrata Tatimore e Kosovës me seli ne Prishtine, përmes te autorizuarit ka ushtruara ankese për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës se dyte aktvendimin e kontestuar te e prish dhe çështjen te e kthej ne rivendosje apo ta ndryshon dhe të refuzoje kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit te vendimit nr. 08/2024 të dates 26.01.2024i Administrata Tatimore e Kosovës.

Kolegji i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhoma e shkallës së dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, dhe pas vlerësimit të aktvendimit të kundërshtuar në pajtim me nenin 194 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për konfliktin administrativ (LKA), ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar.

Duke shqyrtuar shkresat e lëndës, aktvendimin e kundërshtuar sipas ankesës së kunderpropozuesit-te paditurës, kolegji i kësaj gjykate, gjen se Dhomat e Shkallës së Parë, pas shqyrtimit të propozimit të paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit me nr. 08/2024 të dates 26.01.2024 të Administratës Tatimore te Kosovës, ka gjetur se propozimi i tillë është i bazuar, ngase paditësi e ka bërë të besueshme përmes provave të prezantuara dhe ka arritur të vërtetoj se është përmbushur kushti i rrezikut serioz dhe dëmi i riparueshëm, si dhe se ekziston rreziku i shkakimit të dëmit apo humbjeve të tjera, nëse nuk caktohet shtyrja e ekzekutimit të vendimit kontestues, ashtu siç është përcaktuar në nenin 22, paragrafi 6 e lidhur me paragrafin 2, të këtij neni, të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA).

Kolegji i Gjykatës Komerciale - Dhoma e shkallës së dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm një konkludim të tillë të gjykatës së shkallës së parë ngase edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, në rastin konkret janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të paraparë në nenin 22 par. 6 lidhur me par. 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, i cili përcakton se: “ me kërkesë e paditësit, organi akt i te cilit ekzekutohet gjegjësisht organi qe është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri ne vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do ti sillte dem paditësit, i cili vështir do te riparohej, kurse shtyrja nuk është ne kundërshtim me interesin publik, as qe shtyrja do ti sjellte ndonjë dem te madhe palës kundërshtare përkatësisht personit te interesuar”.

Gjykata e Shkalles se pare, me rastin e vendosjes sipas propozimit te paditësit, ka gjetur se shtyrja e ekzekutimit te vendimit deri ne vendosjen e çështjes ne mënyre meritore, është e drejtë kjo ngase për gjykatën ky propozim i propozuesit nuk paraqet element vlerësimi të vet kërkesëpadisë si në padi duke mos paragjykuar këtu çështjen kryesore.

Gjykata e Shkalles se pare ne vendimin e saj, ka konstatuar se paditësja ne pretendimet e saja ka arsyetuar mjaftueshëm se të njëjtat janë të bazuara në Ligj dhe se ne rastin konkret janë përmbushur kushtet Ligjore qe te aprovohet propozimi për shtyrje te ekzekutimit te vendimit deri sa gjykata te vendos përfundimisht lidhur me Ligjshmërinë e vendimit te kontestuar përkitazi me padinë e paditësit e ne kuptim te nenit 22 te LKA-se.

Me që nga provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës rezulton se me vendimin nr. 08/2024 të dates 26.01.2024 të Administratës Tatimore te Kosovës, këtu propozuesi është obliguar ne përmbushjen e detyrimeve tatimore, mirëpo nga provat e administruara te cilat gjinden ne shkresat e lëndës, gjykata e shkalles se pare, erdhi ne përfundim se propozimi/kërkesa e paditësit për shtyrjen e ekzekutimit te aktit administrativ-vendimit nr. 08/2024 të dates 26.01.2024, është e bazuar, për arsye se ne rastin konkret ekziston rreziku real që pa shtyrjen e ekzekutimit te këtij vendimi, paditësi do te mund te pësonte dem te pa riparueshëm, ne rast te mbledhjes se detyrueshme te borxhit tatimor nga ana e te paditurës i cili është objekt i këtij kontesti tregtar administrative, pasi qe nga pasqyrat e llogarive bankare ne NLB Banke për periudhën 01.01.2023 – 16.02.2024, ka konstatuar se këtu paditësi/propozuesi ka bilanc përfundimtar me date 16.02.2024 ne shumën prej 10,024.27, nga pasqyra e llogarisë bankare ne Raiffeisen Bank per periudhën 16.02.2023 – 16.02.2024, ka konstatuar se këtu paditësi/propozuesi ka bilanc përfundimtar me date 12.02.2024 ne shumën prej 3.69 euro, e po ashtu nga Kontratat e kredise bankare për biznes, me numër 214245 ne NLB Banke, në shumën 300,000.00 euro ka gjetur se këtu paditësi/propozuesi ka obligime mujore ndaj kësaj banke ne shumat 7.725.41 euro dhe ka mbetur pa përmbushur detyrimin ne shumen 239,544.30 euro, ndërsa nga Kontratat e kredise bankare për biznes, me numër 8152, në shumën 300,000.00 euro ka gjetur se këtu paditësi/propozuesi ka obligime mujore ndaj kësaj banke ne shumat 5,584.72 euro dhe ka mbetur pa përmbushur detyrimin ne shumen 259,204.00 euro, ku me këto prova vërtetohet gjendja financiare e këtu paditësit/propozuesit, gjendje kjo e pa mjaftueshme për te përmbushur obligimin tatimor ne këtë faze te procedurës.

Andaj duke pas parasysh si lartë gjykata e shkalles se parë, ka marrë aktvendim me të cilin aprovohet kërkesa e paditësit për shtyrje të ekzekutimit të aktvendimit kontestues dhe në këtë mënyrë paditësi do të mund të vazhdoj aktivitetin e tij tregtar, të gjeneroj të ardhura dhe si rrjedhojë do ti jepet mundësia që të mund të paguaj detyrimet e tij.

Gjykata e shkallës së dytë, i mori parasysh edhe pretendimet ankimore të kundër propozueses – te paditurës, se gjendja financiar e propozuesit është e parëndësishme në këtë çështje kontestimore – administrative dhe se kërkesa e propozuesit nuk ka mbështetje ligjore, pasi që (sipas te paditurës) propozuesi është i detyruar në përmbushjen e obligimeve ligjore, megjithatë kjo gjykate (gjykata e shkallës së dytë) i konsideron si të pa bazuara këto kundërshtime në këtë fazë të procedurës dhe se shtyrja e ekzekutimit nuk e prejudikon vendosjen në çështjen kryesore.

Derisa pretendimet në padi dhe përgjigje në ankese të palës paditëse, me të cilat është kërkuar shtyrja e ekzekutimit të aktit administrativ, të atakuar deri në vendosjen sipas padisë së paditësit janë të bazuara dhe se vlerësimi i kolegjit është se janë përmbushur kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit siç parashihet në nenin 6 dhe 22 par.2 të LKA-së.

Mbi këtë gjendje të fakteve kolegji gjen se Gjykata Komerciale Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale dhe nuk është cenuar ligji në dëm të ankuesit me rastin shtyrjes së ekzekutimit të vendimit dhe se pretendimet ankimore janë të pa ndikim për vendosje në mënyrë tjetër, andaj ankesa si e tillë refuzohet, ndërsa aktvendimi i ankimuar vërtetohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 209 par.1 nën b) të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e shkallës së dytë
Kom.Dh.Shk.II.nr.778/24, me datë 05.04.2024

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari
Faton Bajrami, d.v